

VENDIM
Nr.46, datë 31.1.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.565, DATË 9.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MBROJTJEN E SHITRESAVE NË NEVOJË, NGA RRITJA E
ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe të ligjit nr.9465, datë 27.11.2006 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “c” e pikës 1 e vendimit nr.565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie, shtetëror, ose që përfitojnë pension pleqërie, fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes, të punësuar në sektorin publik apo të punësuar në subjekte, juridike fizike, e private a të vetëpunësuar në sektorin privat, brenda territorit të Republikë së Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1.1.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha